

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “IF&C Insurance”, P.O.Box 240, N-1326 Lysaker, Norvegji, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati B.N., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.173/2014 të datës 15.09.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.173/2014 i datës 15.09.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve “IF&C Insurance”, P.O.Box 240, N-1326 Lysaker, Norvegji, me të cilën e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” që në emër të kompensimit të dëmit /kasko regres t’ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve me lartësi prej 22,849.98€, së bashku me normën e kamatës vjetore në lartësi 12% të cilën e ka llogaritur nga data 19.09.2013 e deri në pagesën definitive të detyrimit në afatin partitiv prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim, si dhe në pikën II të dispozitivit në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës e ka detyruar të paditurën t’ia paguaj shumën prej 1,801.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e të paditurës të aprovohet në tërësi si e bazuar, aktgjykimi i atakuar të Priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, Kompania e Sigurimeve “IF&C Insurance” P.O.Box 240, N-1326 Lysaker, Norvegji, me datë 06.03.2014 ka paraqitur padi kundër të paditurës “Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë për kompensimin e dëmit/kasko regres të pasuar nga aksidenti i komunikacionit me datë 03.08.2012, në shumë prej 22,849.08 €, me kamatë vjetore prej 12% të cilën shumë paditësi e ka precizuar pas marrjes së ekspertizës teknike nga eksperti N.Sh. në seancën e datës 09.09.2016.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës,nga raporti i policisë dhe nga aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Kundërvajtje e ka vërtetuar se përgjegjës për aksidentin e datës 03.08.2012 në mes automjetit “Audi” me targa norvegjeze RJ91827 dhe automjetit “Mercedes Benz” me targa 01-562-CF, ishte vozitësi i automjetit “Mercedes Benz” i cili kishte policë të sigurimit nga auto përgjegjësia tek e paditura. Ndërsa për lartësinë e dëmit gjykata e shkallës së parë vlerësimin e vet e ka mbështetur në konstatimin e ekspertit për vlerësimin e dëmit N.Sh., të dhënë në ekspertizën teknike të datës 22.07.2016, sipas të cilit konstatim vlera reale e kompensimit të dëmit të pësuar nga i siguruari i paditësit respektivisht kostoja e riparimit të automjetit të dëmtuar arrin shumën prej 22,849.08€.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 939 të LMD-së, për shkak se nga shkresat e lëndës dhe nga thëniet e palës së paditur rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar ka qenë i siguruari i të paditurës, paditësja ia ka paguar të siguruarit të saj kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësja.

Gjykata i vlerësoi pretendimet ankimore të së paditurës, por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara, sepse e paditura e ka kontestuar kërkesëpadinë nga baza e sajë dhe për nga lartësia mirëpo në shkresat e lëndës gjendet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti përgjithshëm– Divizioni për kundërvajtje, i datës 04.06.2013, me të cilën drejtuesi i automjetit “Mercedez Benz” i drejtuar nga Jakup Brahimi është shpallur përgjegjës për aksidentin e trafikut të ndodhur me datë 03.08.2012, i cili pa u siguruar që të mos rrezikoj ose pengoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, ka lëvizur automjetin e tij prapa dhe e ka goditur në anën e djathtë automjetin e tipit “Audi A6” të siguruar te paditësi, të cilit i ka shkaktuar dëme materiale. Gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vlerësuar edhe lartësinë e dëmit material të pësuar në aksidentin e datës 03.08.2012, në shumën prej 22,849.08 € pasi kompensimi i dëmit është

përcaktuar duke u bazuar në ekspertizën teknike të punuar nga eksperti i makinerisë N.Sh., shumë kjo e vlerësuar nga dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, duke marrë për bazë çmimet e pjesëve të riparimit, çmimet e pjesëve për njësi dhe orëve të punës për riparimin e automjetit sipas tregut të Norvegjisë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të së paditurës, lidhur me kamatën por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara, sepse neni 26, pika 6 i Ligjit mbi Sigurimin e Detyruar nga Auto përgjegjësia përcakton lartësinë e kamatës prej 12% nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi pranë të paditurës ka parashtruar kërkesën për kompensim me datë 19.09.2013 për rimbursimin e borxhit dhe sipas dispozitës së cekur kamata rrjedh nga kjo datë, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kë dispozitë të së drejtës materiale.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr.257/2016 dt. 25.10.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.